

VENDIM
Nr.17, datë 13.1.2006

PËR MIRATIMIN E AFATEVE TË PËRDORIMIT TË ARMËVE, TË TEKNIKËS E TË PAJISJEVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE TË RREGULLAVE PËR TRAJTIMIN E TYRE PAS HEQJES NGA ARMATIMI DHE PËRDORIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 7 e 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimn e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e afateve të përdorimit të armëve, mjeteve dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura, sipas tabelave nr.1 dhe nr.2 që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Në Forcat e Armatosura, arma, mjeti ose pajisja të hiqen nga përdorimi me urdhër të autoritetit përkatës sipas pikës 5 të këtij vendimi, kur janë plotësuar:

- a) vitet e përdorimit, sipas tabelave nr.1 e nr.2;
- b) kilometrat e përshkruara, sipas tabelës nr.1;
- c) orët e punës të kryera, sipas tabelës nr.1;
- ç) numri i të shtënave, të kryera sipas tabelës nr.2.

3. Të gjitha mjetet, pajisjet dhe armatimi, që hiqen nga përdorimi në Forcat e Armatosura, por që kanë vlera përdoruese në gjendjen që janë, lejohen të shiten, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Mjetet, pajisjet dhe armatimi, që hiqen nga përdorimi në forcat e Armatosura, por që nuk mund të shiten si mjete dhe pajisje ushtarake, lejohen t'u nënshtrohen procedurave të asgjësimit, demilitarizimit dhe tjetërsimit të pronës shtetërore.

5. Procedurat dhe përgjegjësitë për heqjen nga përdorimi të armëve, mjeteve dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura janë si më poshtë vijon:

a) Për anijet, avionët, helikopterët dhe raketat tokë-ajër, propozimi për heqjen nga përdorimi të bëhet nga Ministri i Mbrojtjes dhe të miratohet nga Kryeministri;

b) Për armatimin, raketat portative dhe municionet luftarake, mjetet e blinduara, mjetet e transportit dhe sistemet e pajisjet e ndërlihdjes, propozimi për heqjen nga përdorimi të bëhet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe të miratohet nga Ministri i Mbrojtjes;

c) Për pajisjet fushore, makineritë dhe pajisjet e mirëmbajtjes, të komunikimit telefonik, kompjuterike dhe të shëndetësisë, propozimi për heqjen nga përdorimi të bëhet nga komandanti i forcës ose i komandës mbështetëse përkatëse dhe të miratohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

ç) Për burimet e ushqimit elektrik të ndërlihdjes dhe për të gjitha pajisjet e tjera, që nuk përfshihen në shkronjat "a", "b", e "c", propozimi për heqjen nga përdorimi të bëhet nga komandantët e brigadave/regjimenteve dhe të miratohet nga komandanti i forcës ose i komandës mbështetëse përkatëse.

6. Ministri i Mbrojtjes të paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave afatet e përdorimit për armët, mjetet dhe pajisjet, që përdoren nga Forcat e Armatosura, për të cilat nuk janë miratuar afate përdorimi në tabelat që i bashkëlidhen këtij vendimi.

7. Vendimi nr.617, datë 4.12.2002 i Këshillit të Ministrave "Për heqjen nga armatimi dhe përdorimi të një pjese të armëve, teknikës dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura dhe për asgjësimin ose çmontimin dhe shitjen e tyre", i ndryshuar, zbatohet vetëm për mjetet dhe pajisjet ushtarake, që janë hequr nga përdorimi, sipas tabelave që i bashkëlidhen vendimit të mësipërm.

8. Të ardhurat, që do të realizohen sipas pikës 3 të këtij vendimi, të ndahen përkatësisht:

- 10 për qind Buxhetit të Shtetit;
- 90 për qind Ministrisë së Mbrojtjes, për t'u përdorur për nevojat e modernizimit dhe të rristurimit të Forcave të Armatosura.

9. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të nxjerrë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

AFATET E PËRDORIMIT TË ARMËVE, TEKNIKËS DHE PAJISJEVE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tabela nr.1

PËR MJETET DHE PAJISJET USHTARAKE

I.	Mjete të blinduara	Jetëgjatësia në vite	Jetëgjatësia në kilometra	Jetëgjatësia në orë pune
1.	Transportues i blinduar me zinxhirë (TRBL)	30 vjet		750 moto/orë
2.	Transportues i blinduar me goma	25 vjet		800 moto/orë
3.	Tërheqës	35 vjet		750 moto/orë
4.	Tank model 59	35		750 moto/orë
II.	ANIJE	Jetëgjatësia në vite		
1.	Anije transporti e madhe	40		
2.	Minahedhëse e madhe (MHM)	40		
3.	Gjuajtës detar i madh (GJDM)	40		
4.	Gjuajtës detar i vogël (GJDV)	40		
5.	Katër silurues	40		
6.	Anije patrulluese e madhe (A.65 Foot)	40		
7.	Anije silure kapëse	40		
8.	Kateri i radës	40		
9.	Rimorkiator	40		
10.	Cisternë	40		
11.	Dok lundrues	40		
12.	Motoskaf	25		
13.	Anije polumbare	40		
14.	Motogomë	25		
15.	Motobarkë	25		
III.	MJETET AJRORE	Jetëgjatësia në vite		Jetëgjatësia në orë pune
1.	Avion Uti-Mig-17 (Stërvitje)			4200 orë/pune
2.	II-28 (Bombardues) Stërvitje			7200 orë/pune
3.	Avion Mig-19			3600 orë/pune
4.	Avion Jak			6000 orë/pune
5.	Helikopter AB-205	35		Përcaktohet nga uzina riparuese
6.	Helikopter AB-206	35		Përcaktohet nga uzina riparuese
7.	Avion fotografimi AN-2			4800 orë/pune
IV.	MJETE TRANSPORTI	Jetëgjatësia në vite	Jetëgjatësia në kilometra	Jetëgjatësia në orë pune
1.	Motoçikletë	9	45 000	
2.	Autoveturë komerciale	10	200 000	
3.	Autobus	17	300 000	

4.	Mikrobus	12	240 000	
5.	Autoambulancë komerciale	12	150 000	
6.	Autoveturë rikonicioni	14	220 000	
7.	Autoambulancë taktike	14	140 000	
8.	Kamionçinë	14	210 000	
9.	Kamion i lehtë	18	180 000	
70.	Kamion i mesëm	18	180 000	
11.	Kamion i rëndë	20	270 000	
12.	Rimorkio	20	160 000	
13.	Autobot i mesëm	20	200 000	
14.	Autobot i rëndë	18	180 000	
15.	Rimorkiator	22	220 000	
16.	Kamion vetëshkarkues	18	180 000	
17.	Vinç pirun	20	160 000	
18.	Autovinç	20	200 000	
19.	Buldozer i mesëm me goma	20	120 000	
20.	Buldozer i rëndë me goma	20	160 000	
21.	Buldozer me zinxhirë	20		6000
22.	Eskavatorë dhe mjete dhengarkuese	20		8000
V.	PAJISJET FUSHORE	Jetëgjatësia në vite		Jetëgjatësia në orë pune
1.	Furrë mekanike fushore	17		1000
2.	Karro kuzhina	17		1000
3.	Dushe fushore	10		1000
4.	Lavanteri fushore	10		1000
5.	Gjenerator me benzinë	12		1000
6.	Gjenerator diezel deri 10 Kw	15		2500
7.	Gjenerator diezel mbi 10 Kw	15		5000
8.	Pajisje frigoriferike	15		120 000
9.	Soba gatimi fushore	10		1000
10.	Pajisje për pastrimin e ujit	20		1000
VI.	MAKINERI DHE PAJISJE TË MIRËMBAJTJES			
1.	Makineri dhe pajisje metalprerëse, vënë në punë para 1990	33		
2.	Makineri dhe pajisje metalprerëse, vënë në punë pas 1990	20		
3.	Makineri e pajisje elektronike, vënë në punë para 1990	22		
4.	Makineri e pajisje elektronike, vënë në punë para 1990	17		
5.	Makineri e pajisje përpunim druri, vënë në punë para 1990	22		
6.	Makineri dhe pajisje punim druri, vënë në punë pas 1990	18		
7.	Makineri dhe pajisje (kaldajat), vënë në punë para 1990	16		
8.	Makineri dhe pajisje (kaldajat),	13		

	vënë në punë pas 1990			
9.	Pajisje e instrumente testuese, vënë në punë para 1990	16		
10.	Pajisje e instrumente testuese, vënë në punë pas 1990	12		
11.	Makineri e pajisje teknologjike (elektropompa, elektrovinça, kompresor), vënë në punë para 1990	8		
12.	Makineri e pajisje teknologjike (elektropompa, elektrovinça, kompresor), vënë në punë pas 1990	6		
VII.	SISTEMET DHE PAJISJET E NDËRLIDHJES			
a-	Pajisjet e HF në brezin e frekuencës	Jetëgjatësia në vite		Jetëgjatësia në orë pune
1.	RF-5200	20 vjet		
2	RF-5800	25 vjet		
3.	ANPRS/138	20 vjet		
4.	Radiomodem RF 5710 W, 5710 A	20 vjet		
5.	Fieldeworks	20 vjet		
6.	Ndërfaqës	20 vjet		
7.	Getwey	20 vjet		
8.	Hub taktik	20 vjet		
9.	SSB	25 vjet		
b	Pajisjet e VHF/UHF në brezin e frekuencës 30-300 MHz			
1	Rf-5800	20 vjet		
2	Radiostacion SEM-25	10 vjet		
3	Radiostacionm SEM 35	10 vjet		
4	Radiostacion SEM 52	15 vjet		
5	Radiostacion SEM 70	25 vjet		
6	Radiostacion SEM 80	25 vjet		
7	Radiostacion SEM 90	25 vjet		
8	Radiostacion RT 3600	15 vjet		
9	Radiostacion VRC	20 vjet		
10	Radiostacion AN/PRC 77	10 vjet		
11	Reperditor në brezin e frekuencave (136-174) MHz	20 vjet		
12	Radio bazë në brezin e frekuencave (136-174) MHz	15 vjet		
13	Radio Mobil në brezin e frekuencave (136-174) MHz	15 vjet		
14	Radio dore në brezin e frekuencave (136-174)MHz	10 vjet		
c.	Pajisje radiorele në brezin e frekuencave 70 MHz 38 Ghz			
1	Radio rele dixhitale	25 vjet		
2	Radio rele analoge	10 vjet		
ç.	Pajisje të komunikimit telefonik			
1	Central telefonik elektronik deri në 120 nr.	10 vjet		

2	Central telefonik elektronik deri në 250 nr.	20 vjet		
3	Central telefonik elektronik mbi 250 nr.	15 vjet		
4	Aparat telefonik satelitor	20 vjet		
5	Aparat telefonik automatik	10 vjet		
6	Aparat fax	10 vjet		
VIII I.	BURIMET E USHQIMIT ELEKTRIK (BUE)	Jetëgjatësia në vite		Jetëgjatësia në orë pune
1	UPS për personal kompjuter	2-3 vjet		
2	UPS qendror	20 vjet		
3	Stabilizator	20 vjet		
4	Radrizator	20 vjet		
5	Karikues për pila	10 vjet		
6	Gjenerator	15 vjet		
IX.	PAJISJET KOMPJUTERIKE	Jetëgjatësia në vite		Jetëgjatësia në orë pune
1	Personal kompjuter	10 vjet		
2	Lap Top	10 vjet		
3	Printer	10 vjet		
4	Rack	25 vjet		
5	Koncentrator	10 vjet		
6	Modem HDSL	5 vjet		
7	Modem SHDSL	5 vjet		
8	SEITCH	10 vjet		
9	Analizator LAN-i	20 vjet		
10	Router	15 vjet		
11	Tape Dive	10 vjet		
12	Skaner	20 vjet		
13	Server	20 vjet		
14	Fotokopje	10 vjet		
X.	PAJISJE SHËNDETËSIE			
1	Kompjuter tomografie	10 vjet		
2	ECHO	10 vjet		
3	Aparat rontgeni	15 vjet		

AFATET E PËRDORIMIT TË ARMËVE, TEKNIKËS DHE PAJISJEVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tabela nr.2

Nr.	Arma, teknika dhe pajisja	Jetëgjatësia në vite	Sasia e qitjeve (me regjim zjarri teknik normal)	Jetëgjatësia në orë pune
I	Armatimi			
1	Pistoleta		5 000	
2	Pushkë snajper		7 000	
3	Automatik		12 000	
4	Mitroloz i lehtë		15 000	

5	Mitroloz kompanie		10 000	
6	Mitroloz i rëndë		10 000	
7	Granatëdhënëse e lehtë Kundërtank (GHLKT)		1 000	
8	Mortajë 60 mm		5 000	
9	Mortajë 82 mm		6 000	
10	Top 75 mm		5 000	
11	Pistoleta shenjëdhënëse		5 000	
12	Obuz 122 mm		4 500	
13	Top 122 mm		4 500	
14	Top obuz 152 mm		4 500	
15	Mitroloz KA 12.7 mm		9 000	
16	Top KA 37 mm		7 000	
17	Raketë portative (shtrat lëshimi)	10 vjet		
18	Top KA 57 mm		7 000	
19	Raketa tokë-ajër (SAM 2)	25 vjet		